



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Në bazë të nenit 72 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, në bazë të nenit 61.27, 61.28 dhe 61.29 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik, si dhe në bazë të kontratës së lidhur më datë 07.08.2023 ndërmjet Operatorit Ekonomik BASHKIM METI SH.P.K me numër të biznesit 811336529 & Aksi - Projekt Sh.P.K, me numër të biznesit 811367699 dhe Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal i Prishtinës, me datë 02.07.2024, Komuna e Prishtinës, respektivisht Zyra e Prokurimit, nxjerr këtë:

**VENDIM**

*Për ndërprerjen e kontratës me titull "Ndërtim i rrugës Gllgovicë Grexhenik dhe krahu i rrugës L.Vitija - Ritender LOT 3"*

*Me nr. të prokurimit: 616-22-11288-5-1-1*

1. **NDËRPREHET** kontrata me Operatorin Ekonomik BASHKIM METI Sh.P.K & Aksi - Projekt Sh.P.K, e nënshkruar më datë 07.08.2023, përfaqësues: Afrim Beka, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtim i rrugës Gllgovicë Grexhenik dhe krahu i rrugës L.Vitija - Ritender LOT 3", me nr. të prokurimit: 616-22-11288-5-1-1.
2. Kontrata ndërprehet pa asnjë kusht për kompensim.
3. Autoriteti Kontraktues vendos që të ndërprejë së implementuari kontratën për "Ndërtim i rrugës Gllgovicë Grexhenik dhe krahu i rrugës L.Vitija - Ritender LOT 3", me nr. të prokurimit: 616-22-11288-5-1-1, sipas rekomandimit për shkëputje të kontratës nga menaxheri i kontratës.
4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për te gjitha palët në ëeb faqen e komunës dhe në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

**ARSYETIM**

Autoriteti Kontraktues - Kuvendi Komunal i Prishtinës më datë 07.08.2023, ka lidhur kontratën për "Ndërtim i rrugës Gllgovicë Grexhenik dhe krahu i rrugës L.Vitija - Ritender LOT 3", me nr. të prokurimit: 616-22-11288-5-1-1.

Bazuar në rekomandimin për ndërprerje të kontratës të datës 03.06.2024, në raportin e datës 29.05.2024, Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim për shkëputje të kontratës.

Sipas raporteve dhe rekomandimit për shkëputje të kontratës, arsyet për ndërprerjen e kontratës janë mospërbushja e kushteve kontraktuale, duke neglizhuar në vazhdimësi ri-fillimin e punëve, edhe pas kontaktimit dhe vërejtjeve të vazhdueshme në drejtim të Operatorit Ekonomik.

Autoriteti Kontraktues ka bërë përpjekje dhe ka kontaktuar disa herë me Operatorin Ekonomik, mirëpo OE ka qenë neglizhent në vazhdimësi dhe shumë e papërgjegjshme pasi që qysh nga fillimi ka pasur pretendime që të distancohet nga përbushja e detyrave të parapara me kontratë dhe si rezultat Autoriteti Kontraktues pas rekomandimit nga ana e menaxherit të kontratës, ka ardhur në përfundim që të bëhet shkëputja e kontratës për mospërbushje.

Poashtu, Departamenti i Prokurimit do të filloj procedurën për inicimin e konfiskimit të sigurimit të ekzekutimit sipas kushteve të kontratës.

Kjo marrëveshje ndërmjet palëve është arritur në mënyrë të njëanshme nga Autoriteti Kontraktues në bazë të kushteve të veçanta të kontratës.

**Bashkangjitur:**

1. Raporti i dt. 29.05.2024
2. Rekomandimi për shkëputje të kontratës i dt. 03.06.2024

Prishtinë, 02.07.2024

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

Perparim RAMA

Kryetar i Komunes  
Komuna e Prishtinës

**Vendimi i dërgohet:**

1. Operatori Ekonomik: "BASHKIM METI Sh.P.K & Aksi - Projekt Sh.P.K;
2. Menaxherit të Kontratës;
3. Sektorit të Prokurimit.